



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Zyra për Komunikim Publik/ Ured za Javno Komuniciranje/ Public Communication Office

RAPORT GJITHËPËRFSHIRËS

I INSTITUCIONEVE PUBLIKE PËR REALIZIMIN E SË

DREJTËS PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

Raporti vjetor 2016

Prishtinë, mars 2017

Përmbajtja

Faqe

1. Përmbledhje	3
2. E drejta e qasjes në dokumente publike	
2.1 Parimet themelore	4
2.2 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë	4
2.3.1 Aktet juridike	4
3. Raportet lidhur me lirinë e informimit	6
4. Kërkesat për qasje në dokumente publike	
4.1 Institucionet e mbuluara me Ligjin Nr. 03/ L-215 për Qasje në Dokumente Publike	7
4.2 Institucionet që nuk kanë dërguar raport	8
4.3 Presidenca, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese	
4.3.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe Gjykatë Kushtetuese	11
4.3.2 Analizë e kërkesave të parashtruara.....	11
4.4 Qeveria e Republikës së Kosovës	
4.4.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në institucionet vartëse	15
4.4.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Kosovës dhe në institucionet vartëse	18
4.5 Universitetet publike	
4.5.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Universitetet publike.....	22
4.5.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Universitetet publike	22
4.6 Institucionet e Pavarura	
4.6.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Institucionet e Pavarura	25
4.6.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Institucionet e Pavarura	26
4.7 Ndërmarrjet Publike	
4.7.1 Numri i kërkesave të parashtruara në ndërmarrje publik.....	30
4.8 Komunitetet e Republikës së Kosovës	
4.8.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Komunitetet e Republikës së Kosovës	32
4.8.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Komunitetet e Republikës së Kosovës	33
5. Shtojcat	
5.1 Formulari i kërkesës për qasje në dokumente publike	37
5.2 Lista e kontakteve	38

HARTUES I RAPORTIT:
ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT

Albulena Sylaj-Zeqiri, Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun dhe Trajtimin e Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike

1. PËRMBLEDHJE

Zyra për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeministrit është obliguar me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike të përgatis Raport Gjithëpërfshirës vjetor, për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike. Ky është raporti i gjashtë vjetor që përgatitet nga Zyra për Komunikim Publik.

Ajo që vërehet me këtë Raport është numri i vogël në përgjithësi i kërkesave për qasje në dokumente publike në gjithë Republikën. Numrin më të madh të kërkesave gjatë vitit 2016, e kanë pasur komunat me gjithsej

Kjo ka bërë që edhe në këtë vit, realizimi i përgjithshëm i qasjes në dokumente publike të jetë i lartë.

Ajo që vërehet nga viti i kaluar është numri më i madh i kërkesave të pranuar nga qytetarët, të cilët kanë kërkuar kryesisht dokumente që kanë të bëjnë me konkurset publike.

Në klasifikimin e shteteve bazuar në legjislacionin e tyre për të drejtën e qasjes në dokumente publike, Kosova është radhitur në vendin e 25të.

2 E DREJTA E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE

2.1 Parimet themelore

Në Kosovë, Ligji për Qasje në Dokumente Publike bazohet në dhjetë parimet mbi të drejtën për qasje në informata:¹

1. Qasja në informata është e drejtë e secilit;
2. Qasja është rregull- sekreti është përjashtim;
3. E drejta aplikohet tek të gjitha organet publike;
4. Bërja e kërkesës duhet të jetë e thjeshtë, e shpejtë dhe e lirë;
5. Zyrtarët kanë për detyrë t'u ndihmojnë kërkuarëve të informatave ;
6. Refuzimi duhet të arsyetohet;
7. Interesi publik është më i rëndësishëm se sekreti;
8. Secili ka të drejtë të ankohet ndaj vendimit të pafavorshëm;
9. Organet publike duhet në mënyrë proaktive të publikojnë informatat thelbësore;
10. E drejta duhet të garantohet nga një organ i pavarur.

2.2 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë

E drejta për qasje në dokumente të institucioneve publike të Kosovës hyn në kuadër të të drejtave dhe lirive themelore të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Secili individ e gëzon të drejtën për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parasheh të drejtën për qasje në dokumente publike në nenin 41. Në frymën e këtij neni, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Qasje në Dokumente Publike më 7 tetor, 2010.

2.2.1 Aktet juridike

Qasja në dokumente publike në Republikën e Kosovës rregullohet me këto akte juridike:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton:

"1. Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike."

"2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë."

¹ PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR TË DREJTËN E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE, Përgatitur nga: BESIM M. KAJTAZI
<http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/I. PERMBLEDHJE LEGJISLACIONI PER TE DREJTEN E QASJES NE DOKU.pdf>

- **Ligji Nr.03/ L-215 për Qasje në Dokumente Publike**

Ligji për Qasje në Dokumente Publike garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.

Në funksion të zbatimit me sukses të Ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar:

- ▶ **Rregullorja nr. 03/2011 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun;**
- ▶ **Rregullorja nr. 1/2012 për Kodin e Etikës për zyrtarët e komunikimit me Publikun;**
- ▶ **Rregullorja nr. 04/2012 për evidencën zyrtare të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe pakoja e dokumenteve standarde për kërkesat për QDP;**
- ▶ **Rregullore nr. 02/2012/MF për tarifatat në qasje në dokumente publike;**
- ▶ **Udhëzim Administrativ (MAP) nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike**
- ▶ **Udhëzimi Administrativ nr. 02/2011, për portalin qeveritar të Republikës së Kosovës.**
- ▶ **Udhëzim Administrativ nr. 2008/09 për transparencën në komuna**

- **Ligjet tjera të ndërlidhura**

- Ligji nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale
- Ligji nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë
- Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit
- Ligji nr. 02/L-28 për procedurën administrative
- Ligji nr. 03/L-202 për konfliktet administrative
- Ligji nr. 04/L-184 për administrimin e punës në Zyrë

3. RAPORTET LIDHR ME LIRINË E INFORMIMIT


Gjatë vitit 2016 ka pasur një numër të Raporteve për Kosovën, të cilat kanë mbuluar edhe realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.

Në klasifikimin e të Drejtës për Informim, program i financuar nga dy organizata “Access Info Europe (AIE)” dhe “Centre for Laë and Democracy”, Kosova ka rënë në klasifikim për katër pozita. Derisa vitin e kaluar ishte në pozitën e 21-të, tash radhitet e 25-ta në mesin e 111 shteteve.

Kosovo

Name of law : Law on Access to Public Documents

First adopted : 2003

Download Report 

Download Law 

SECTION	MAX SCORE	SCORE
Right of Access	6	2
Scope	30	25
Requesting procedures	30	23
Exceptions	30	22
Appeals	30	21
Sanctions	8	2
Promotional measures	16	11
TOTAL	150	106




Figura 1.

Pikët e fituara të Kosovës në klasifikimin e të Drejtës për Informim

Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian në faqen 18 flet pikërisht për Ligjin .

“Qasja në informata publike është e garantuar me Ligjin për qasje në dokumente publike, e miratuar në vitin 2010”

Raporti përmend këtë fushë edhe në faqet 22-23.

“Progres është bërë në mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërgjegjësimi i publikut për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale është përmirësuar, duke rezultuar me numër të rritur të ankesave të pranuar nga Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pos kësaj, Agjencia ka përfunduar më shumë inspektive. Agjencia duhet të përgatitet për sfidat në zbatimin e rregullave për mbrojtjen e të drejtave personale si rezultat i Marrëveshjes për Stabilizim Asociim. I duhen më shumë burime financimi dhe fuqizim i kapaciteteve njerëzore, përfshirë rizgjedhjen e mbikëqyrësve për tu marrë me shqyrtimin e numrit të rritur të ankesave. Amandamentimet e ligjeve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike janë të nevojshme dhe korniza institucionale ende nuk është e qartë” thuhet në raport.

4 KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

4.1 Institucionet e përfshira në këtë Raport gjithëpërfshirës

Në këtë Raport janë të përfshirë të dhënat mbi 160 institucione në të gjitha nivelet, të cilat kanë obligim që të zbatojnë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Fillimisht janë prezantuar të dhënat për tri institucione të nivelit qendror:

- Presidenca e Republikës së Kosovës
- Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Më pas, janë prezantuar të dhënat për Qeverinë, përfshirë ministritë dhe agjencitë vartëse, me gjithsej 80 institucione.

Sa i përket institucioneve të pushtetit lokal, janë prezantuar të dhënat për 38 komuna.

Nga institucionet tjera janë përfshirë raportet për pesë universitete publike, 17 ndërmarrje publike dhe 25 institucione të pavarura, të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha këto institucione, janë 5 institucione të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që nuk raportojnë, si dhe dy komuna të Republikës së Kosovës (shih 4.3)




Figura 2.

Institucionet e përfshira në Raportin Gjithëpërfshirës për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike

4.3 INSTITUCIONET QË NUK KANË DËRGUAR RAPORTE

4.3.1 Institucionet e Republikës së Kosovës të cilat nuk kanë dërguar raporte

Mungesa e raportimit nga Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial lë jashtë raportit edhe Gjykatat dhe Prokuroritë tjera të Kosovës², pasi janë pikërisht këto Këshille përgjegjëse për mbledhjen e raporteve nga institucionet e tyre vartëse dhe dërgimit të raportit tek Zyra për Komunikim në ZKM.

Më poshtë është paraqitur lista e institucioneve të cilat nuk kanë dërguar raporte për kërkesat për qasje në dokumente publike.

- Avokati i Popullit
- Agjencioni Kosovar i Inteligjencës
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Këshilli Prokurorial i Kosovës
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

- Komunitet të cilat nuk kanë dërguar raporte

Më poshtë është tabela e komunave të cilat nuk kanë përgatitur dhe dërguar raporte për kërkesa për qasje në dokumente publike.

- Komuna e Zveqanit
- Komuna e Zubin Potokut

² Rregullore nr 04/2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike, neni 5:

- pika 4: "Gjykatat raportin nga paragrafi 1 i këtij neni ia dërgojnë Këshillit Gjyqësor të Kosovës i cili përmbledh raportin dhe ia dërgon Zyrës për Komunikim me Publikun të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit;

-pika 5: "Prokuroritë e Kosovës nga paragrafi 1 i këtij neni ia dërgojnë Këshillit Prokurorial të Kosovës i cili përmbledh raportin dhe ia dërgon Zyrës për Komunikim me Publikun të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit".

4.3 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

4.3.1 Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës

Tabela nr. 1:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2016 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Totali
Institucionet qendrore: Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	20	0	1	21
Qeveria, përfshirë ministritë dhe agjencitë vartëse	599	31	41	671
Institucionet e Pavarura	173	5	3	181
Universitetet	87	2	0	89
Ndërmarrjet Publike	122	2	0	124
Komunat	1049	22	12	1083
Totali	2050	62	57	2169

Tabela nr. 2:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2015 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Totali
Institucionet qendrore: Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	22	2	2	26
Qeveria, përfshirë ministritë dhe agjencitë vartëse	785	69	33	887
Institucionet e Pavarura	205	13	1	219
Universitetet	75	0	0	75
Ndërmarrjet Publike	84	1	2	87
Komunat	789	31	18	838
Totali	1960	116	56	2132

Tabela nr. 3:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2014 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore: Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	27	2	4	0	0	33
Qeveria, përfshirë ministritë dhe agjencitë vartëse	736	9	25	25	56	851
Institucionet e Pavarura	201	5	0	0	1	207
Universitetet	41	1	0	1	0	43
Ndërmarrjet Publike	15	1	0	0	0	16
Komunat	846	18	9	24	26	923
Totali	1866	36	38	50	83	2073

4.3.2 Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës

Numri i kërkesave të pranuar gjatë gjithë viteve që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, është pothuajse i njëjtë, afër 2 mijë kërkesa në vit. Nga të gjitha këto kërkesa të pranuar, shumica e tyre kanë marrë qasje të plotë nga institucionet publike.




Figura 3.

Realizimi i përgjithshëm i së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës – krahasimi i tri viteve të fundit

4.4 PRESIDENCA, KUVENDI I KOSOVËS DHE GJYKATA KUSHTETUESE

4.4.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe Gjykatë Kushtetuese

Gjatë vitit 2016, në tri institucionet qendrore janë pranuar 21 kërkesa gjatë gjithë vitit.

Tabela më poshtë pasqyron numrin e kërkesave të parashtruara në institucionet qendrore të Republikës së Kosovës.

Tabela nr. 4:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Emri i institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Totali
Presidenca e Republikës së Kosovës	10	0	0	10
Kuvendi i Republikës së Kosovës	3	0	0	3
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	7	0	1	8
	20	0	1	21

4.3.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Tabela më poshtë pasqyron totalin e kërkesave të parashtruara në këto institucione.

Tabela nr 5:

Totali i kërkesave të shqyrtuara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Totali
20	0	1	21

- Realizimi i qasjes në dokumente publike

Gjatë vitit 2016, në Zyrën e Presidentes, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese, janë realizuar 95 për qind e të gjitha kërkesave për qasje në dokumente publike. Në 5 për qind të rasteve është ofruar qasje e pjeshme.

Në figurën janë paraqitur të dhënat që prezantojnë realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike në tri institucionet e mësipërme qendrore të Republikës së Kosovës.




Figura 4.
Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Presidencë, Kuvend dhe Gjykatë Kushtetuese

- Dërgimi i përgjigjeve në kërkesa

Tri institucionet qendrore, gjatë vitit 2016 kanë dërguar të gjitha përgjigjet në afatin e paraparë me ligj.

Nuk ka pasur asnjë kërkesë e cila është refuzuar .

- Forma e kërkesave të pranuar dhe e përgjigjeve të dërguara

Më së shumti, kërkesat e drejtuara tek Zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese, kanë qenë në formën elektronike, që përbën 90 për qind të të gjithë kërkesave të pranuar. Vetëm në 10 për qind të rasteve, kërkuessit kanë sjell kërkesën e tyre në kopje fizike.




Figura 5.
Forma e kërkesave të pranuar

Në këto kërkesa, tri institucionet përgjigjet e dërguara në 71 për qind i kanë dërguar në formë elektronike, 24 për qind në kopje fizike, ndërsa në formë elektronike dhe kopje fizike në 5 për qind të rasteve.



Figura 6.
Mënyra e dërgimit të përgjigjeve

- Profili i aplikuesve

Qytetarët kanë qenë kërkuarit më të shpeshtë të dokumenteve zyrtare gjatë vitit 2016 në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe në Gjykatën Kushtetuese. Nga të gjitha kërkesat e pranuar, 38.09 për qind e tyre ishin nga qytetarët, pasuar nga gazetarët me 33.33 për qind, studentët me 19.04 për qind dhe kërkesat nga shoqëria civile që përbënin 9.54 të kërkesave totale.




Figura 7.
Profili i kërkuarëve të dokumenteve

- Dokumentet e kërkuara Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe në Gjykatë Kushtetuese

Më së shumti janë kërkuar statistika gjatë gjithë vitit 2016 në Presidencë, Kuvend të Kosovës, dhe në Gjykatë Kushtetuese. 28.57 për qind e të gjitha kërkesave të marra nga këto tri institucione ishin për statistika. Kopje të kërkesave individuale dhe buxhet e shpenzime, janë kërkuar në 19.04 për qind të rasteve. Vendime janë kërkuar 14.28 për qind nga të gjitha kërkesat, rregullore 9.55 për qind, ndërsa projektligje dhe kontrata secila nga 4.76 për qind.




Figura 8.
Dokumentet më të kërkuara tek institucionet qendrore

4.4 QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

4.4.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse

Qeveria e Republikës së Kosovës, përfshirë Zyrën e Kryeministrit, ministritë dhe agjencitë tjera vartëse, gjatë vitit 2016 ka pasur gjithsej 671 kërkesa. Institucioni me numrin më të madh të kërkesave mbetet Dogana e Kosovës, me gjithsej 354 kërkesa të pranuar.

Më poshtë është tabela që pasqyron numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse.

Tabela nr.6 :

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse

	Emri i institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e pjeshme	Totali
1	Zyra e Kryeministrit	13	6	0	19
2	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>	13	0	0	13
3	<i>Agjencia për Barazi Gjinore</i>	0	0	0	0
4	<i>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë</i>	18	2	4	24
5	<i>Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore</i>	0	0	0	0
6	Ministria e Integritit Evropian	5	0	0	5
7	Ministria për Komunitete dhe Kthim	6	0	0	6
8	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	9	0	0	9
9	<i>Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës</i>	0	0	0	0
10	<i>Agjencia Kadastrale e Kosovës</i>	7	0	0	7
11	Ministria e Punëve të Brendshme	25	0	0	25
12	<i>Policia e Kosovës</i>	2	0	0	2
13	<i>Akademia e Kosovës për Siguri Publike</i>	1	0	0	1
14	<i>Agjencioni për Menaxhim Emergjent</i>	2	0	0	2
15	<i>Agjencioni për Regjistrim Civil</i>	/	/	/	/
16	<i>Inspektorati Policor i Kosovës</i>	/	/	/	/

17	Agjencioni i Kosovës për Forenzikë	0	0	0	0
18	Ministria e Diasporës	6	0	0	6
19	Ministria e Administratës Publike	10	3	0	13
20	Instituti i Kosovës për Administratë Publike	0	0	0	0
21	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	0	0	0	0
22	Ministria e Infrastrukturës	8	0	0	8
23	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	0	0	0	0
24	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	4	2	4	10
25	Instituti Pedagogjik	1	0	0	1
26	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve	1	0	0	1
27	Qendra e Studentëve	0	0	0	0
28	Biblioteka Universitare				
29	Agjencia e Kosovës për Akreditim	1	2	0	3
30	Agjencia për Aftësim Profesional dhe për të Rritur e Kosovës	0	0	0	0
31	Instituti Albanologjik i Prishtinës	0	0	0	0
32	Inspektoriati i Arsimit në Republikën e Kosovës	0	0	0	0
33	Instituti i Historisë	0	0	0	0
34	Instituti i Leposaviqit	/	/	/	/
35	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	12	0	1	13
36	Agjencioni Pyjor i Kosovës	0	0	0	0
37	Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë	0	0	0	0
38	Ministria e Drejtësisë	5	0	0	5
39	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar	0	0	0	0
40	Shërbimi Korrektues i Kosovës	/	/	/	/
41	Ministria e Financave	24	2	0	26
42	Administrata Tatimore e Kosovës	9	1	0	10
43	Dogana e Kosovës	332	0	22	354

44	<i>Agjencioni Qendror i Prokurimit</i>	0	0	0	0
45	<i>Njësia e Inteligjencës financiare</i>	0	0	0	0
46	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	4	0	0	4
47	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	14	0	6	20
48	<i>Agjencia e Shtetërore e Arkivave të Kosovës</i>	3	0	0	3
49	<i>Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"</i>	0	0	0	0
50	<i>Teatri Kombëtar i Kosovës</i>	0	0	0	0
51	<i>Qendra Kinematografike e Kosovës</i>	0	0	0	0
52	<i>Galeria Kombëtare e Kosovës</i>	0	0	0	0
53	<i>Galeria e Ministrisë "Qafa"</i>	0	0	0	0
54	<i>Ansambli Kombëtar Shtetëror i Këngëve dhe Valleve "SHOTA"</i>	0	0	0	0
55	<i>Filarmonia e Kosovës</i>	0	0	0	0
56	<i>Kosovafilmi</i>	0	0	0	0
57	<i>Baleti i Kosovës</i>	0	0	0	0
58	<i>Muzeu i Kosovës</i>	0	0	0	0
59	<i>Instituti Arkeologjik i Kosovës</i>	0	0	0	0
60	<i>Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve</i>	0	0	0	0
61	<i>Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore</i>	0	0	0	0
62	Ministria e Punëve të Jashtme	2	7	0	9
63	<i>Akademia diplomatike e Kosovës</i>	0	0	0	0
64	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	19	3	1	23
65	<i>Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës</i>	0	0	0	0
66	Ministria e Shëndetësisë	18	0	2	20
67	<i>Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës</i>	1	1	0	2
68	<i>Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale</i>	0	0	0	0
69	<i>Instituti i Kosovës për Shëndetësi Publike</i>	0	0	0	0
70	<i>Qendra Kombëtare për Transfuzion të Gjakut e Kosovës</i>	0	0	0	0

71	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	6	0	0	6
72	<i>Agjencia Kosovare e Standardizimit</i>	0	0	0	0
73	<i>Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare</i>	0	0	0	0
74	<i>Agjencia e Promovimit të Investimeve e Kosovës</i>	0	0	0	0
75	<i>Drejtoria e Akreditimit të Kosovës</i>	0	0	0	0
76	<i>Agjencia e Metrologjisë së Kosovës</i>	0	0	0	0
77	<i>Agjencia për Pronësi Industriale</i>	0	0	0	0
78	<i>Inspektoriati i Tregut</i>	0	0	0	0
79	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	12	2	1	15
80	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	6	0	0	6
		599	31	41	671

4.4.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Kosovës dhe në institucionet vartëse

Tabela e mëposhtme prezanton totalin e kërkesave për qasje në dokumente publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve vartëse duke përfshirë edhe mënyrën e trajtimit të kërkesave.

Tabela nr. 7:

Institucioni/ njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e pjesshme	Totali
ZKM dhe Ministrinë	208	25	15	248
Agjencitë e ZKM-së dhe të Ministrive	391	6	26	423
	599	31	41	671

Siç shihet në Tabelën e mësipërme, kemi bërë ndarjen e këtyre institucioneve në dy grupe;

- **Grupi i parë:** Zyra e Kryeministrit dhe Ministrinë,
- **Grupi i dytë:** Agjencitë në përbërje të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

- Realizimi i qasjes në dokumente publike

Gjatë gjithë vitit, Qeveria është përgjigjur në shumicën e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike, duke refuzuar një numër shumë të vogël të tyre. Qasje të pjesshme iu është ofruar 6.11 për qind të të gjitha kërkesave, 4.61 është refuzuar, ndërsa është lejuar qasja në 89 për qind të kërkesave të marra.




Figura 09.
Realizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës

- Refuzimet

Më shumë se gjysma e refuzimeve të kërkesave të pranuar gjatë vitit 2016, 52 për qind, janë bërë sipas nenit 10, pa përgjigje nga ana e institucioneve. Po ashtu, institucionet qeveritare nuk kanë raportuar se kanë lëshuar aktvendim me shkrim për të refuzuar qasjen në dokumente publike, sipas nenit 13, pika dy, të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Arsyet tjetër e refuzime është mbrojtja e të dhënave personale, 32 për qind të refuzimeve, si dhe 16 për qind për shkak të diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështje.




Figura 10.
Refuzimet e bëra nga Qeveria e Republikës së Kosovës

- Forma e kërkesave të pranuar dhe forma e dërgimit të përgjigjeve

Në formë elektronike edhe në vitin 2016 janë pranuar më së shumti kërkesa, në 92 për qind nga të gjitha kërkesat e pranuar. Në kopje fizike janë pranuar vetëm 6 për qind, ndërsa edhe në kopje elektronike dhe kopje fizike janë pranuar 2 për qind e të gjitha kërkesave.




Figura 11.
Forma e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike

Nga këto kërkesa të pranuar, gjatë vitit 2016, Qeveria është përgjigjur në mënyrë elektronike në 92 për qind të rasteve. Përgjigjet janë dërguar si kopje në letër në 4 për qind të rasteve, po aq sa janë dërguar edhe në të dy format, elektronike dhe kopje fizike.




Figura 12.
Mënyra e dërgimit të përgjigjeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

- Profili i aplikuesve

Shumica e kërkesave në Qeverinë e Republikës së Kosovës kanë ardhur nga gazetarët. Nga të gjitha kërkesat e marra, 62 për qind janë nga gazetarët, 21 nga shoqëria civile, 6 nga individë, 5 për qind nga studentët, ndërsa nga 2 për qind kanë ardhur nga kompanitë private, organizatat buxhetore, dhe të tjera.




Figura 13.
Profili i aplikuesve të kërkesave për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës

- Dokumentet e kërkuara

Gjatë gjithë vitit 2016, në Qeverinë e Republikës së Kosovës më së shumti janë kërkuar statistika, 53 për qind nga të gjitha kërkesat e pranuar, pasuar nga dokumentet që përmbajnë informata buxhetore dhe shpenzime, 21 për qind, 6 për qind të kërkesave kanë ardhur për vendime, po aq sa edhe për kontrata, 5 për qind për projekte sa edhe për tenderë. Dy për qind e kërkesave të pranuar ishin për projekt akte, ndërsa nga një për qind për raporte dhe konkurse.




Figura 14.
Llojet e dokumenteve të kërkuara në Qeverinë e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2016

4.5 UNIVERSITETET

Tabela e mëposhtme tregon numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike, si dhe mënyrën e trajtimit të tyre.

Tabela nr. 8:
Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara tek universitetet publike

	<i>Emri i Institucionit</i>	<i>Qasja e lejuar</i>	<i>Qasja e refuzuar</i>	<i>Qasja e pjeshme</i>	<i>Totali</i>
1	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	52	0	0	52
2	Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"	27	1	0	28
3	Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	1	0	0	1
4	Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"	2	0	0	2
5	Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"	5	1	0	6
		87	2	0	89

4.5.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Universitete

Më poshtë është tabela me totalin e kërkesave për qasje në dokumente publike të universiteteve publike dhe mënyrës së trajtimit të këtyre kërkesave.

Tabela nr. 9:
Totali i kërkesave për qasje në dokumente publike në universitetet publike

<i>Universitetet publike</i>	<i>Qasja e lejuar</i>	<i>Qasja e refuzuar</i>	<i>Qasja e kufizuar</i>	<i>Totali</i>
	87	2	0	89

- Realizimi i qasjes në dokumente publike

Gjatë gjithë vitit 2016, Universitetet publike kanë refuzuar vetëm 3 për qind të kërkesave të tyre, ndërsa nuk ka pasur asnjë rast kur është ofruar qasje e pjeshme.




Figura 15.
Realizimi i qasjes në dokumente publike tek universitetet publike

- Forma e kërkesave të pranuar dhe e përgjigjeve të dërguara

Tek universitetet publike, shumica e kërkesave për qasje në dokumente publike gjatë vitit 2016 janë dorëzuar në kopje në letër, 72 për qind, ndërsa vetëm 28 për qind e tyre janë dorëzuar në formë elektronike.




Figura 16.
Forma e pranuar e kërkesave për qasje në dokumente publike

Universitetet publike kanë kthyer 34 për qind të përgjigjeve të tyre në mënyrë elektronike, kopje në letër 28 për qind, ndërsa elektronike dhe kopje në letër 38 për qind të përgjigjeve të dërguara gjatë vitit 2016.




Figura 17.
Mënyra e dërgimit të përgjigjeve

- Profili i aplikuesve

Më së shumti kërkesa tek universitetet publike, gjatë gjithë vitit 2016, ka pasur nga inspektorati të cilët kanë bërë 31 për qind të të gjitha kërkesave. 24 për qind e kërkesave u pranuan nga gazetarët, 21 për qind nga studentët, 15 për qind nga individë, 8 për qind nga shoqëria civile dhe 1 për qind nga organizata tjera buxhetore.




Figura 18.

Profili i kërkesve të dokumenteve për qasje në dokumente publike, tek universitetet publike

- Dokumentet e kërkuara

Gjatë gjithë vitit 2016, në universitete publike më së shumti janë kërkuar vendime, që përbën 43 për qind të të gjitha kërkesave të pranuar. Kontrata janë kërkuar 26 për qind nga të gjitha kërkesat e pranuar, 18 për qind dokumente që lidhen me konkurse publike, statistika 6 për qind, ankesa 3 për qind, 2 për qind buxhet dhe shpenzime, ndërsa nga një për qind janë kërkuar projektligje dhe të tjera.




Figura 19

Dokumentet më të kërkuara tek universitetet publike

4.6 INSTITUCIONET E PAVARURA

4.6.1 Numri i kërkesave të parashtruara në institucionet e pavarura

Tek institucionet e pavarura, të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, numri i kërkesave për qasje në dokumente publike gjatë vitit 2016 ishte i vogël, vetëm 181.

Tabela 10:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në institucionet e pavarura

	<i>Emri i Institucionit</i>	<i>Qasja e lejuar</i>	<i>Qasja e refuzuar</i>	<i>Qasja e kufizuar</i>	<i>Totali</i>
1	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	5	0	0	5
2	Komisioni i Pavarur i Mediave	6	0	0	6
3	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil	14	0	2	16
